



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202101580/2

Tiranë ___/___/2021

Lënda: *Rekomandime për inspektimin e kryer në ambientin e shoqërimit dhe të sigurisë në Drejtorinë/Komisariatit e Policisë Kukës.*

Drejtuar: Drejtues i parë Edmond SULAJ
Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Kukës

KUKËS

Kryekomisar Dritan METAJ
Shef i Komisaritit të Policisë Kukës

KUKËS

Të nderuar zotërinj,

Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim "Mekanizmi Kombëtar" ose MKPT, seksion pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar dhe nenin 81 të ligjit nr.81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", kreu një inspektim në ambientin e shoqërimit dhe të sigurisë në Drejtorinë/Komisariatit e Policisë Kukës.

Inspektimi u krye në datën 23.11.2021, sipas një Plani Inspektimi të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin z.Besnik Deda dhe z.Hazbi Selita me detyrë nd/komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

Inspektimi kishte si qëllim verifikimin e respektimit të standardeve të përcaktuara në ligjin nr.108/2014, "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar, Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, për miratimin e procedurës standarde "Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre", Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 938 datë 24.07.2019, për miratimin e procedurës standarde të punës "Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit", si dhe zbatimin

e rekomandimeve të Avokatit të Popullit nga inspektimi i mëparshëm i zhvilluar më datë 16.12.2020¹.

Institucioni i Avokatit të Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga inspektimi i mëparshëm, ka detyrimin kushtetues dhe ligjor t'ju parashtojë konkluzionet përfundimtare, referuar si më poshtë vijon:

Shënime të përgjithshme

Në përputhje me metodologjinë e zhvillimit të inspektimit në institucionet ku mbahen e trajtohen shtetas të privuar nga liria, grupi i inspektimit nuk pati mundësi të takohej me drejtuesit e policisë në DVP dhe Komisariatin e Policisë Kukës, pasi për arsye pune, nuk ndodheshin në institucion. Në mungesë dhe me porosi të tyre, grupi i inspektimit u takua me përgjegjësin e dhomave të sigurisë dhe punonjësit e shërbimit në zyrën e informacionit të këtij komisarati.

Pasi u prezantua, grupi i inspektimit i njohu ata me qëllimin e inspektimit dhe kontrolloi në vend kushtet e krijuara për mbajtjen dhe trajtimin e personave në ambientin e shoqërimit dhe ambientin e sigurisë në Komisaratin e Policisë Kukës. Gjithashtu, grupi i punës zhvilloi intervista me personelin e shërbimit të policisë në këto ambiente dhe personin i cili ndodhej me masë sigurie në dhomat e sigurisë, në lidhje me procedurat që ndiqen për respektimin e të drejtave të personave që shoqërohen dhe sigurohen në këto mjedise, si dhe verifikoi zbatimin e rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i zhvilluar në vitin 2020.

Më tej, grupi i inspektimit vizitoi zyrat e punonjësve të policisë që kryejnë veprime procedurale me personat e shoqëruar dhe të ndaluar/arrestuar, si dhe u njoh e administroi kopje të dokumentacionit ku pasqyrohen veprimet e kryera me këta persona, nga momenti i hyrjes në mjediset e komisarariatit.

Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të bëra nga Institucioni i Avokatit të Popullit nga inspektimi i mëparshëm, grupi i inspektimit konstatoi se:

1. Nuk ishte plotësuar rekomandimi, për krijimin e një ambienti më vete për shoqërimin dhe intervistimin e të miturve, sipas dispozitave të parashikuara në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur, si dhe procedurat standarde të miratuara për këtë qëllim.
2. Nuk ishte plotësuar rekomandimi, për vendosjen e pajisjeve të sigurisë (sisteme kamerash audio – vizive) në dhomën e intervistimit/marrjes në pyetje të të arrestuarve/ndaluarve, me qëllim regjistrimin në elektronikë të procesit të marrjes në pyetje apo veprimeve të tjera procedurale hetimore me të arrestuarit/ndaluarit².

¹Shkresë nr.K4/152-2 prot., datë 30.12.2020 dërgohen "Rekomandime pwr inspektimin e kryer në Drejtorinë/Komisariatit e Policisë Kukës".

² Kreu XIV, pika 6.1 dhe 6.2/b e procedurës standarde "Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre".

3. Nuk ishte plotësuar rekomandimi, për krijimin e një ambienti më vehte në dhomat e shoqërimit, ku të merret në pyetje personat e shoqëruar para se të kalojnë në dhomat e sigurisë.

Ndërkohë, nga inspektimi u evidentua se:

1. Zbatohej rekomandimi që personat e shoqëruar dhe të ndaluar/arrestuar, të pajisen me letrën e të drejtave që në momentin e hyrjes së tyre në mjediset e Komisarariatit të Policisë.
2. Në ambientet e brendshme të institucionit, si dhe në ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë, ishin të afishuara rregullat e përgjithshme për parandalimin e COVID-19, sipas protokollit shëndetësor për këtë qëllim.

Grupi i inspektimit, nuk arriti të merrte një informacion mbi arsyet e mos realizimit të rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit të vitit të kaluar, pasi në momentin e inspektimit, në institucion nuk ndodhej asnjë prej drejtuesve të Drejtorisë/Komisariatit të Policisë Kukës.

Në vijim, grupi i inspektimit kontrolloi zbatimin e masave për parandalimin e sëmundjes infektive COVID-19, në ambientet e punës të punonjësve të policisë, në ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë, si dhe në zyrën e shërbimeve për qytetarët, sipas protokollit shëndetësor të miratuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Nga inspektimi u evidentua se, institucioni kishte të miratuar një rregullore të brendshme për zbatimin e masave anti COVID-19. Punonjësit e policisë në vendin e punës ishin të pajisur me maska mbrojtëse, ruanin distancimin fizik dhe social me njëri tjetrin dhe me qytetarët.

Në vende të aksesueshme, ishin vendosur dizifektantë për pastrimin e duarve. Në hyrje të institucionit, punonjësi i shërbimit kryente matjen e temperaturës për të gjithë punonjësit e policisë dhe për vizitorët, si dhe orientonte për të kaluar përmes një urë dizifektuese. Të gjitha veprimet regjistroheshin në një regjistër të veçantë.

Grupi i inspektimit, u informua se furnizimi me maska mbrojtëse, dizinfektantë për larjen e duarve dhe pajisja me doreza mbrojtëse, kryhej rregullisht sipas një grafiku çdo 3 muaj nga DVP Kukës, njëherësh për tre komisarariatet e policisë në varësi të saj. Po ashtu, ambientet e punës, si dhe dhomat e shoqërimit dhe të sigurisë, ishin të dizinfektuara çdo muaj prej fillimit të pandemisë, nga subjekte të licensuara nga DVP Kukës dhe Bashkia Kukës.

U konstatua se, në ambientet e komisarariatit, si dhe në ambientin e shoqërimit dhe të sigurisë, ishin të afishuara postera me rregullat e përgjithshme për parandalimin e pandemisë.

Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre

Mjedisi i shoqërimit në Komisarlatin e Policisë Kukës, në përgjithësi është i ndërtuar sipas kërkesave të ligjit nr.108/2014 *“Për Policinë e Shtetit”*, i ndryshuar, si dhe procedurës standarde *“Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”*, miratuar me Urdhrin nr.938 datë 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Ambienti i shoqërimit nuk plotësonte kushtet e mbajtjes të personave të shoqëruar, sipas përcaktimeve në procedurën standarde ku midis të tjerave thuhet se *“Mjediset/ambientet të jenë të ndara më vehte për persona të rritur, femra (gra) dhe të mitur”*³.

Ambienti ndodhet në një godinë më vehte nga godina e Komisarlatit të Policisë, brenda territorit të Drejtorisë/komisariatit dhe përbëhet nga 2 (dy) dhoma shoqërimi, të ndara në 1(një) dhomë shoqërimi për personat e rritur dhe 1(një) dhomë e përbashkët shoqërimi për gra dhe të mitur.

Efektivisht në këtë ambient mungon një dhomë shoqërimi, e cila do të bëjë të mundur ndarjen e personave të shoqëruar gra nga të mitur, sikurse parashikohet në kreu VII, pikën 4/b të procedurës standarde ku thuhet se *“Mjediset/ambientet të jenë të ndara më vehte për persona të rritur, femra dhe të mitur”*.

Dhomat e shoqërimit ishin me përmasa 3mx4m secila dhe kishin sipërfaqe dhe hapësirë të bollshme për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar. Ato ishin të pajisura me orenditë e nevojshme, me një tavolinë pune për specialistët e policisë dhe katër karrige për qëndrimin ulur të të shoqëruarve, të cilat ishin të fiksuara në dysheme, të palëvizshme dhe të paçmontueshme.

Kapaciteti fizik për secilën dhomë shoqërimi ishte për qëndrimin ulur të 4 deri 5 personave. Dhomat kishin dritare, përmasat e të cilave krijojnë mundësi për ajrimin dhe ndriçimin e plotë natyral. Ato kishin dhe ndriçim artificial që furnizohej nga rrjeti elektrik.

Në korridorin e ambientit të shoqërimit, ndodheshin dy tualete të ndara më vehte për meshkuj dhe për gra, të cilat ishin të pajisura me nyje hidrosanitare dhe kishin furnizim me ujë të rrjedhshëm gjatë 24 orëve.

Dhomat e shoqërimit dhe ambientet ndihmëse që ndodheshin në këtë mjedis, ishin të lyera dhe të pastra nga ana higjieno-sanitare.

Në ambientin e shoqërimit, ndodhej dhoma për njohjen e personit e përbërë nga dy dhoma, të cilat ndaheshin në mes me xham pasqyrë dhe përdorej nga oficerët e policisë gjyqësore për identifikimin dhe njohjen e personit, në rastet kur ai dyshohej për kryerjen e një vepre penale.

³ Kreu VII, pika 1,2 dhe 4 të procedurës standarde *“Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”*.

Sipas informacionit, në mungesë të një dhome të veçantë, marrja në pyetje e personave të shoqëruar kryhej ende në zyrat e punës të punonjësve të policisë. Nga inspektimi i zyrave të punës, nuk u konstatuan sende apo mjete që të eksopozonin dhunë psikologjike te personat e shoqëruar, gjatë marrjes në pyetje nga specialistët e policisë.

Gjithashtu, në mjedisin e shoqërimit, grupi i inspektimit **nuk** konstatoi sende apo mjete të tilla që mund të shërbejnë për kryerjen e vetëvrasjeve apo për kundërveprim ndaj punonjësit të policisë.

Korridori dhe ambienti i shoqërimit monitorohej nga 2 kamera, të cilat administrohen nga DVP Kukës dhe pamjet filmike ruheshin deri në 15 ditë.

Në ambientin jashtë dhomave të shoqërimit dhe brenda tyre, ishin të afishuara postera me kartën e të drejtave të personave të shoqëruar në mjediset e policisë së shtetit.

Në momentin e inspektimit, në dhomat e shoqërimit nuk ndodhej asnjë person në cilësinë e të shoqëruarit sipas përcaktimit në ligjin nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar. Ndërsa, nga verifikimi i regjistrimit për evidentimin e të dhënave të personave të shoqëruar për periudhën Janar – Nëntor 2021, ishin shoqëruar në këto mjedise 289 persona, nga të cilët 4(katër) gra dhe 6(gjashtë) të mitur në konflikt me ligjin.

Ambientet e sigurisë dhe kushtet e tyre

Ambienti i sigurisë në Komisarriatin e Policisë Kukës, ishte i ndërtuara sipas kërkesave të ligjit nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, për miratimin e procedurës standarde “*Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre*”.

Ai përbëhej nga 6 (gjashtë) dhoma sigurie, të cilat ishin të ndara 4 (katër) dhoma për personat e rritur, 1(një) dhomë për gra dhe 1(një) dhomë për të mitur. Dhomat e sigurisë ishin të ndërtuara sipas normave dhe parametrave të përcaktuara në procedurën standarde, të ndara në dhomë dhe paradhomë, me një skarë hekuri dhe derë në mes të saj.

Dhomat e sigurisë plotësonin normat dhe parametrat teknik jetësorë, për një person të arrestuar apo ndaluar, pasi sipërfaqja e përgjithshme ishte jo më pak se 10 m², e ndarë në ambient qëndrimi (dhomë) me sipërfaqe 6 m² dhe paradhomë me sipërfaqe 4 m².⁴

Dhomat ishin të pajisura me nga një krevat me elementë hekuri (dy nga dhomat kishin 2 krevatë), një ËC e fiksuar në mënyrë të paçmontueshme dhe pa depozitën e ujit, si dhe me buton zileje/sinjali i montuar në mur për kontakt me punonjësën e shërbimit në rast nevojë. Ato ishin të kompletuara me dyshekë, batanie dhe jastëk për fjetje.

⁴ *Kreu VII, pika 3.3 e procedurës standarte “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”.*

Në ambientin e paradhomës ishin të vendosura dhe të instaluara pajisjet për tu larë (lavaman së bashku me rubinetin e ujit), depozitë uji për ËC-në, pajisje elektrike si çelës dhe llampa për ndriçim të përshtatshëm të paradhomës e dhomës së qëndrimit, si dhe një pajisje për ngrohje qëndrore gjatë dimrit.

Kapaciteti i dhomave të sigurisë ishte për mbajtjen, sigurimin dhe trajtimin e 8(tetë) personave të ndaluar/arrestuar. Në dhomat e sigurisë të këtij komisariati, sigurohen dhe trajtohen personat e arrestuar apo të ndaluar nga punonjësit e policisë të komisariateve Kukës dhe Has.

Nisur nga numri i dhomave të sigurisë, kushtet e brendshme dhe kapaciteti i tyre, ato e përballonin numrin e personave të ndaluar/arrestuar nga punonjësit e policisë të këtyre komisariateve.

Në momentin e inspektimit në dhomat e sigurisë ndodhej vetëm një person, i cili ishte në moshë madhore në cilësinë e të arrestuarit. Ndërsa, për periudhën Janar - Nëntor 2021, në regjistrin e personave të ndaluar/arrestuar u evidentua se ishin siguruar 163 persona, nga të cilët 2 gra dhe 2 të mitur. Nga verifikimi i regjistrit për personat e ndaluar/arrestuar, nuk u evidentua raste të mbipopullimit në dhomat e sigurisë.

Dritaret e dhomave ishin me përmasa të tilla që mundësonin futjen e sasisë së mjaftueshme të ajrit dhe dritës natyrale. Gjithashtu, dhomat kishin ndriçim artificial që furnizohej nga rjeti elektrik. Ambienti i sigurisë ishte i lyster dhe i pastër nga ana higjieno-sanitare.

Në korridorin e ambientit të sigurisë ndodhej zyra e përgjegjësit të dhomave të sigurisë, dhoma për intervistimin/marrjen në pyetje nga përfaqësuesi i organit të akuzës dhe për takime me avokatin mbrojtës, si dhe dhoma e mjekut për kryerjen e vizitave mjeksore.

Zyra e përgjegjësit të dhomave të sigurisë, kishte një raft për mbajtjen e regjistrave dhe dokumentave të përcaktura në procedurën standarde si regjistri për evidentimin e personave të arrestuar/ndaluar, regjistri i sendeve personale, regjistri i marrjes në pyetje nga prokurorë, oficerë të policisë gjyqësore, regjistri i takimeve me mbrojtësit ligjorë (avokatë e kujdestarë), mbrojtësit e të drejtave të njeriut Avokatin e Popullit, OJF etj., regjistri i evidentimit të vizitës mjeksore që kryhet menjëherë pas arrestimit/ndalimit dhe vizitat mjeksore që kryhen në qendrat spitalore, regjistri i kërkesë/ankesave, etj. Te gjithë regjistrat ishin të sekretuar me vulë nga sekretaria e institucionit.

Ambienti i intervistimit apo marrjes në pyetje ishte i pastër nga ana higjieno-sanitare, me ajrosje dhe ndriçim të plotë natyral dhe artificial (elektrik). Ai ishte i pajisur me karrige për qëndrimin ulur dhe tavolinë pune, të fiksuara në mënyrë të palëvizëshme. Punonjësit e policisë gjyqësore apo prokurori, prezantoheshin para se të kryenin veprimet procedurale me personat e arrestuar apo të ndaluar. Ajo nuk kishte pajisje sigurie (sisteme kamerash

audio – vizive) për të regjistruar në elektronikë procesin e marrjes në pyetje apo veprime të tjera procedurale hetimore me të arrestuarit/ndaluarit⁵.

Dhoma e mjekut ishte e pajisur me orenditë dhe pajisjet e nevojshme si tavolinë pune e mjekut e fiksuar në dysheme dhe e pa lëvizshme, karrige pune, një kasafortë e mbyllur me bravë për mbajtjen e barnave të ndryshme mjeksore dhe të dokumentacionit për shërbimin mjekësor, si dhe krevat për kryerjen e vizitave dhe kontrolleve mjekësore me të arrestuarit/ndaluarit. Dhoma ishte e pajisur me sistem për ngrohje. Për çdo person të arrestuar apo të ndaluar, hapej kartela mjeksore dhe ishin të plotësuara nga ndihmësmjeku, i cili ishte në organikë të DVP Kukës.

Në fundin e korridorit në ambientin e sigurisë, ndodhej një ambient i përbashkët tualeti dhe dushi me ujë të ngrohtë, për larjen e trupit.

Ambienti i sigurisë kishte sistem qendror për ngrohjen e të gjitha ambienteve në periudhën e dimrit. Në korridorin e këtij ambienti, kishte aparat telefonik fiks për t'u përdoruar nga punonjësit e shërbimit në rastet e tentativave apo ngjarjeve të rënda me të ndaluarit/arrestuarit, për të kërkuar ndihmë dhe ndërhyrje të shpejtë.

Ambienti për intervistimin e personave shërbente njëkohësisht edhe si dhomë për takimin e të ndaluarve/arrestuarve me avokatët mbrojtës, të cilat realizoheshin sa herë kërkohej nga ana e tyre.

Hyrja kryesore e ambientit të sigurisë, korridori i tij dhe hyrjet në dhomat e sigurisë monitoroheshin me 2 kamera përgjatë 24 orëve, pamjet e të cilave ruheshin deri në 30 ditë.

Në rastet, kur personat e ndaluar/arrestuar ishin shtetas të huaj, zbatoheshin procedura e njoftimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe përfaqësisë diplomatike e vendit të tyre, si dhe pajiseshin me kartën e të drejtave në gjuhën e tyre amtare apo në një nga gjuhët që ata kuptojnë nëpërmjet avokatit mbrojtës dhe një përkthyesi. Në zyrën e përgjegjësit të dhomave të sigurisë ndodhej letra me të drejtat e shtetasve të huaj që ju privohet liria në mjediset e policisë e përkthyer në 10 gjuhë të huaja kryesore.

Regjistri i personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar dhe evidentimi i tyre

Në Komisariatin e Policisë Kukës “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr.1”, konform procedurës standarde “*Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit*”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938 datë 24.07.2019. Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë, sipas dispozitave të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit.

⁵ *Kreu XIV, pika 6.1 dhe 6.2 e procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”*

Nga këqyrja e regjistrit për personat e shoqëruar rezultoi se ai ishte i sekretuar, por **nuk** ishte i plotësuar sipas të gjitha rubrikave të përcaktuara në procedurën standarde⁶. Konkretisht, në rubrikën për njoftimin e familjes **mungonte** emri i personit të njoftuar, lidhja me të shoqëruarin, si dhe numri i telefonit të familjarëve. Në disa nga rastet e tjera të shoqërimit, në regjistër **mungonte** edhe përshkrimi i arsyeve të shoqërimit, ora e shoqërimit të personave dhe ora e lënies të lirë. Kjo praktikë, përbën shkelje të standardeve dhe mos kryerje të detyrës nga punonjësit e policisë që kryejnë shërbim në zyrën e informacionit të këtij komisariati. Njëkohësisht, këto shkelje çojnë në dyshime të arsyeshme se, një pjesë e shënimeve mund të jetë fiktive, përse nuk ka të dhëna në lidhje me identifikimin e familjarëve.

Koha e qëndrimit në ambientin e shoqërimit të shtetasve ishte e ndryshme nga 1 deri 4 orë, por jo më shumë se 10 orë. Në rastet kur akti/veprimi i shoqërimit kryet nga oficeri/agjenti i policisë gjyqësore për personin nën hetim, në bazë të nenit 295.2 të Kodit të Procedurës Penale, afati kohor i mbajtjes së personit nën hetim ishte brenda 12 orëve.

Të dhënat për personat e ndaluar/arrestuar evidentoheshin në regjistrin e personave të ndaluar/arrestuar, i cili ishte i sekretuar. Ky regjistër ishte i plotësuar me korrektësi në të gjitha rubrikat e tij.

Nga verifikimi i fashikujve ku evidentohen rastet e shoqërimit dhe të arrestimeve/ndalimeve, të kryera nga punonjësit e komisariateve të policisë në varësi të DVP Kukës, u konstatua se zbatohet rekomandimi i Avokatit të Popullit, për ndryshimin e praktikës së viteteve të kaluara lidhur me orën e arrestimit dhe ndalimit të shtetasve, duke shënuar në procesverbalet e arrestimit në flagrancë apo ndalimit, orën faktike kur ata janë shoqëruar për në organin e policisë, pra orën kur personit i është privuar liria dhe jo orën kur përpilohet procesverbali përkatës.

Rekomandimet e Avokatit të Popullit janë bazuar jo vetëm në parimet universale të së drejtës dhe në parimet e përgjithshme të së drejtës tonë penale, por edhe në dispozitat konkrete të Kodit të Procedurës Penale, respektivisht nenet 144, 250 dhe 259 të tij.

U evidentua se, në ambientin e shoqërimit **mungonte** një regjistër i veçantë për regjistrimin e kërkesë/ankesave. Punonjësi i policisë në zyrën e informacionit nuk kishte dijeni për ekzistencën e regjistrit të ankesave (për shkak se nuk ka në organikë punonjës policie në zyrën e informacionit), ndërkohë që në inspektimin e vitit të kaluar Komisarati e kishte një regjistër të tillë. Sipas informacionit të punonjësit të policisë që kryente shërbim në zyrën e informacionit, kërkesë/ankesat shënoheshin në rubrikën përkatëse që ndodhet në regjistrin për personat e shoqëruar, si dhe në proces verbalin e shoqërimit që firmoset në përfundim të procedurave nga specialisti i policisë dhe personi i shoqëruar, kopjen e të cilit ata e marrin me vete.

⁶ *Kreu VII, procedurës standarde "Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit".*

Gjithashtu, në zyrën e informacionit ndodhej dhe regjistri për evidentimin e të dhënave për personat e shoqëruar të mitur, në bazë të rekomandimit të Avokatit të Popullit për këtë qëllim.

Trajtimi i të ndaluarve/arrestuarve dhe i të shoqëruarve në ambientet e policisë.

Në momentin e inspektimit në ambientet e shoqërimit dhe në ambientin e sigurisë të Komisarariatit të Policisë Kukës, ndodhej vetëm një person në cilësinë e personit të arrestuar. Nga intervista që zhvilloi grupi i inspektimit me këtë person, nuk u konstatuan ankesa apo pretendime në lidhje me keqtrajtimin apo përdorimin e forcës tej kufijve të lejuar, nga punonjësit e policisë gjatë kohës të shoqërimit për në mjediset e komisarariatit dhe qëndrimit të tij në dhomat e sigurisë.

Nga informacioni dhe intervista me personin e arrestuar rezultoi se, të ndaluarit/arrestuarit trajtoheshin me ushqim tre herë në ditë (të miturit katër herë në ditë), sipas normave për trajtimin me ushqim të përcaktuar në urdhrin e përbashkët nr.432, datë 10.03.2008 të Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Shëndetësisë. Ushqimi përgatitej në kuzhinën e Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Kukës, brenda të njëjtës godinë ku ndodheshin ambientet e sigurisë të këtij komisaritati. Guzhinierja ishte e pajisur me librezën shëndetësore (e përditësuar) të vendosur në stendën ku paraqitej menyuja javore.

Ndonëse në ambientet e sigurisë nuk kishte ambiente kulti, të ndaluarve/arrestuarve që dëshironin u lejohej të predikonin ritet fetare brenda dhomave të sigurisë.

Të ndaluarit/arrestuarit furnizoheshin rregullisht me produkte për ruajtjen e higjienës vetjake dhe të ambientit si sapun, detergjente, letra higjienike dhe letra për fshirjen e duarve dhe të fytyrës. Kjo u verifikua dhe në intervistën e zhvilluar me personin e arrestuar që ndodhej në dhomat e sigurisë.

Nga informacioni i përgjegjësit të dhomave të sigurisë, gjatë periudhës së pandemisë, personat që ndodhen në dhomat e sigurisë, janë furnizuar me sapun dhe detergjente mbi normativën, për mbajtjen e higjienës personale, mbajtjen pastër të ambientit të dhomës dhe ambienteve të përbashkëta.

Koha e qëndrimit në dhomat e sigurisë, ishte brenda fatave të përcaktuar në Kodin e Procedurës Penale, deri në 96 orë, për vleftësimin e masës së sigurisë nga gjykata.

Personat e ndaluar, për të cilët gjykata ka lëshuar vendim të formës së prerë “arrest me burg”, transferoheshin menjëherë në ambientet e I EVP Kukës, që ndodhej në të njëjtën godinë me dhomat e sigurisë të Komisarariatit të Policisë Kukës.

Ambientet e intervistimit

Në ambientet e sigurisë të Komisarariatit të Policisë Kukës, kishte një dhomë për marrjen në pyetje të shtetasve të ndaluar/arrestuar nga përfaqësuesit e akuzës dhe për takim me avokatët. Ajo ishte e pajisur me orenditë e nevojshme si karrige dhe tavolinë të fiksuara në dysHEME të palëvizëshme, por siç e theksuam dhe më lart, ajo nuk monitorohej me sistemin e kamerave audio-vizive.

Ndërsa në ambientin e shoqërimit, mungonte një dhomë e veçantë për intervistimin/marrjen në pyetje kryesisht të personave të arrestuar në flagrancë apo të dyshuar për kryerjen e një veprë penale, para se ata të kalojnë në dhomat e sigurisë. Në të gjitha rastet, personat e shoqëruar merren në pyetje/intervistohen në zyrat e punës të punonjësve të policisë, të cilat nuk ishin në vëzhgim dhe monitorim të kamerave, gjatë kryerjes të veprimeve procedurale me këta persona.

Avokati i Popullit e konsideron procesin e monitorimit filmik një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit ndaj tyre⁷.

Nga inspektimi që u krye në zyrat e oficerëve të policisë gjyqësore në këtë komisarariat, nuk u gjetën sende prania e të cilave të ekspozonte dhunë psikologjike tek personat me të cilët ata kryenin veprime procedurale. Në këtë komisarariat ishte krijuar një dhomë (magazinë) për administrimin dhe ruajtjen e provave materiale, deri në përfundim të hetimit nga organi i akuzës.

Ndihma juridike, psikologjike dhe kujdesi mjekësor

Gjatë inspektimit, u konstatua se në korridorin e ambienteve të sigurisë dhe të shoqërimit në Komisarariatit të Policisë Kukës, ishin të afishuara posterat me të drejtat e personave të ndaluar/arrestuar, si dhe atyre të shoqëruar.

Ndërsa për shtetasit e ndaluar/arrestuar të huaj ishin përgatitur letrat me të drejtat e të ndaluarve/arrestuarve në disa gjuhë të huaja, si anglisht, frëngjisht, italisht, greqisht, gjermanisht, maqedonisht, serbisht dhe sllovenisht.

Sipas punonjësve të policisë, personat e ndaluar/arrestuar dhe të shoqëruarit njiheshin që në fillim të veprimeve procedurale, me të drejtën për të patur një avokat mbrojtës gjatë marrjes në pyetje nga punonjësit e policisë. Ata që e kishin kërkuar u ishte krijuar menjëherë mundësia për të kontaktuar me të. Në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit, të cilët

⁷ “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standarteve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim, po ashtu; kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohet që të regjistrohet në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkësë të bërë nga i ndaluarit gjatë intervistës, si dhe të personave të pranishëm gjatë çdo interviste.” Raporti i CPT-së për Armeninë: CPT/Inf (2016) 31 [par.20].

nuk kishin mundësi financiare për të pajtuar avokat privat dhe kërkonin ndihmë juridike, ju sigurohej mbrojtja me avokat kryesisht.

Ndërsa, në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës dhe të psikologut i cili ishte në organikë të DVP Kukës.

Avokatët mbrojtës siguroheshin nga lista e avokatëve e dërguar nga organi i prokurorisë. Përgjegjësi i dhomave të sigurisë kishte listën e avokatëve dhe numrat e telefonave të tyre.

Personave të ndaluar dhe arrestuar, në momentin kur ju komunikohesh masa e arrestit me burg, iu jepeshin nga oficerët e policisë gjyqësore kopje të proces-verbalit të ndalimit/arrestimit, të kontrollit personal dhe kopja e letrës me të drejtat e tyre. Një gjë e tillë u verifikua nga dokumentet që dispononte personi që ndodhej në dhomat e sigurisë në momentin e inspektimit.

Ndërsa, personave të shoqëruar në mjediset e policisë u jepej karta me të drejtat e tyre, që në momentin e hyrjes në komisariatet e policisë. Në përfundim të kohës së shoqërimit, këtyre personave iu jepej gjithashtu edhe kopje e proces-verbalit me arsyet e shoqërimit.

Grupi i inspektimit, konstatoi se vizitat mjekësore kryheshin nga ndihmësmjeku, brenda afatit 12 orësh nga momenti i vendosjes së këtyre personave në ambientin e sigurisë, sikurse përcaktohet në procedurën standarde *“Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”*.⁸

Ndihmësmjeku ishte në organikë të DVP Kukës dhe ishte i punësuar me kohë të plotë. Ai pasqyronte në regjistrin e vizitave mjekësore konstatimet, rekomandimet dhe mjekimet e dhëna gjatë vizitave mjekësore për të ndaluarit/arrestuarit. Gjithashtu, në fashikullin e çdo të ndaluar/arrestuar që administrohej nga përgjegjësi i dhomave të sigurisë, ndodhej kartelat mjekësore (kartelat ditore) për secilin prej tyre.

Në ambientin e sigurisë, ishte e afishuar lista e personave të miratuar që kanë të drejtë të hyjnë në këtë ambient, lista e avokatëve mbrojtës, si dhe ishte afishuar numri i kontaktit me zyrën e Avokatit të Popullit.

Në këtë komisariat, zbatohesh detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr. 108/2014 *“Për Policinë e Shtetit”*, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika 1/f të procedurave standarde *“Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e policisë së shtetit”*, për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse.

⁸ *Kreu II, pika 7.2 e procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”.*

Për sa më sipër, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku përcaktohet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”, nenit 21/b të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”, si dhe nenit 81, pika 2/b të ligjit 81/2020 ku përcaktohet se Mekanizmi Kombëtar ushtron këto kompetenca: “paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues”:

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave për krijimin e një dhomë shoqërimi dhe intervistimin për personat e mitur, e cila të jetë e ndarë më vehte nga dhoma e shoqërimit për personat e rritur dhe për gra, sikurse përcaktohet në dispozitat e Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur dhe procedurën standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”.
2. Marrjen e masave për krijimin në ambientin e shoqërimit e një dhome për marrjen në pyetje të të shoqëruarve (para se të kalojnë në dhomat e sigurisë), e cila të jetë e plotësuar me pajisje e orendi pune për specialistët e ndihmës specialistët e policisë si tavolina e karrige, si dhe stola për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar, të cilat të jenë të fiksuara dhe të pa lëvizshme.
3. Të merren masat e nevojshme, për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera, në dhomën për marrjen në pyetje/intervistimin e të ndaluarve/arrestuarve nga oficerët e policisë gjyqësore, që ndodhet në ambientet e sigurisë të këtij komisariati.
4. Të merren masa të menjëhershme, për organizimin e trajnimeve me stafin e punonjësve të policisë që kryejnë shërbim në zyrën e informacionit, për plotësimin e regjistrit të të shoqëruarve sipas të gjitha rubrikave, evidentimin e të dhënave të sakta të tyre mbi arsyen e shoqërimit, orën e shoqërimit të personave në mjediset e policisë së shtetit, orën e lënies të lirë të tyre, si dhe të rubrikës për njoftimin e familjarëve me emrat, lidhjen familjare me të shoqëruarin dhe telefonat e tyre, sipas përcaktimeve në procedurën standarde dhe rekomandimeve CPT-së për këtë qëllim.
5. Të merren masa të menjëhershme, për vendosjen në zyrën e informacionit të komisariatit, të regjistrit për evidentimin e kërkesë/ankesave të të shoqëruarve.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONER

Ermonela XHAFA